



VENDIM

Nr. 162, Datë 28.12.2015

MBI

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “KISI – BIO - ENERGJI” SH.P.K, PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SAJ SI KOLATERAL PRANË RAIFFEISEN BANK

Në mbështetje të neneve 16, 44, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 6, 7 dhe 8, të Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licensës “Për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, mbasi shqyrtoi kërkesën për lënien peng të asetëve të shoqërisë “KISI – BIO - ENERGJI” sh.p.k si kolateral pranë Raiffeisen Bank, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “KISI – BIO - ENERGJI” sh.p.k plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit si më poshtë:

- Neni 7, pikat 1.1 dhe 1.2 (Janë paraqitur në mënyrë korrekte.)
- Neni 7, pika 1.3, gërmat “b”, “e”, (Janë paraqitur në mënyrë korrekte.)
- Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (Ky informacion është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.)

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me: nenin 7, pika 1.3, gërmat “a”, “c”, “d”, “f”, “g”, “h” do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 9 të Rregullores së Transferimit të asetëve, ti paraqesë ato brenda afatit të caktuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI :

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “KISI – BIO - ENERGI” sh.p.k për lënie peng si kolateral të aseteve të shoqërisë pranë Raiffeisen Bank.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI